



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d), dhe nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 dt. 2008”), nenit 11. paragrafi 2 i Ligjit Nr.2003/24 për Sportin (“Gazeta zyrtare IPVQ, Nr. 22 dt.01.Mars 2008”), nenit 5. të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL. Nr. 0203 – 76, të dt. 24.01.2013,dhe nenit 8, paragrafi 1, e nenit 9, paragrafi 1, pika d) të Statutit të Komunës së Pejës,01. Numër:09 – 8103, date: 29.Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, pas procedurës së diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më date: 30 janar 2015, miraton:

## **RREGULLORE KOMUNALE Nr. 02/2015 për objektet Sportive në Parkun “Karagaq” në Pejë**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo rregullore për Objektet Sportive në Parkun “Karagaq” (tani e tutje: Objektet Sportive) ka për qëllim rregullimin dhe definimin e pronësisë, menaxhimin, organizimin e brendshëm, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe aktivitetet që zhvillohen në objektet sportive në fjalë.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

- a) **Objektet Sportive në parkun “Karagaq”** nënkupton të gjitha objektet sportive të cilat gjenden në parkun “Karagaq” siq janë: Palestra e sporteve “Karagaq”, Palestra “Partizan”, fusha e sportit e hapur afër palestres “Partizan”, fushat e Tenisit afër palestres “Karagaq”.
- b) **Salla “Partizan”** nënkupton sallën e vogël që gjendet në parkun “Karagaq”.
- c) **Fusha e hapur e sportit** nënkupton hapsirën sportive që ndodhen në parkun “Karagaq” që është e rrethuar dhe që është ngjitur me palestren “Partizan”
- d) **Fushat e Tenisit** janë haspira sportive në pjesën e jashtme të palestres por janë pjesë përbërse e palestres. Ato shërbejnë vetëm për ndeshje të tenisit.
- e) **DKRS** nënkupton Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport dhe është drejtorati kompetent për menagjimin e objekteve sportive.

### **Neni 3**

#### **Pronësia e Objekteve Sportive**

- a) Objektet sportive të cekura në Nenin 2, rreshti a), janë pronë e komunës së Pejës dhe komuna e Pejës është autoriteti zyrtar kompetent për menaxhimin e tyre.

### **Neni 4**

#### **Fushëveprimi i Rregullores**

Kjo rregullore njofton, definon dhe rregullon këto çeshtje:

- a) Njofton për strukturën menagjeriale dhe operative të objekteve sportive.
- b) Definon funksionet hapsirave sportive.
- c) Definon kush janë palët që kanë të drejtë të shfrytëzojnë objektet sportive.
- d) Definon cilat janë kushtet që duhet plotësuar nga palët për shfrytëzimin e objekteve sportive
- e) Definon përgjegjësitë që kanë palët për shfrytëzimin e këtyre objekteve.
- f) Definon mënyrën e sponsorizimit dhe reklamimit në objektet sportive.
- g) Rregullon cmimet për shfrytëzimin e hapsirave të objekteve sportive.
- h) Rregullon procedurat për investime apo për ndryshime në objektet sportive nga palët e interesuara.

### **Neni 5**

#### **Struktura organizative e objekteve sportive**

- a. Struktura organizative e objekteve sportive përcaktohet me organogramin e komunës respektivisht DKRS-së.
- b. Struktura organizative për menaxhimin e objekteve sportive përbëhet nga zyra administrative e palestres, kujdestaria e objekteve sportive, punëtorët teknik, mirëmbajtja e pastërtisë, puntorët e sigurisë.
- c. Klubet Sportive, respektivisht përfaqësuesit e klubeve që kanë marrëveshje me menaxhmentin e palestres së sporteve janë partner dhe konsiderohen persona përgjegjës për kohën kur zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive.

### **Neni 6**

#### **Funksioni i Objekteve Sportive**

- a. Funksioni primar i objekteve sportive është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, koncerte, tubime dhe ngjarje të organizuara ekonomike.

- b. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të sporteve të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketbolli, Hendbolli, Volejbolli, Futsalli dhe sportet luftarake të licensuara.
- c. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete promovuese dhe tubime të fushatave politike.
- d. Në palestër mund të zhvillohen edhe aktivitete tjera sportive të cilat vlersohen si jo të rrezikshme për dëmtimin e dyshemes dhe ambienteve tjera.
- e. Fushatë e Tenisit janë në funksion vetëm të Tenisit, dhe ato shfrytëzohen për stërvitje dhe për ndeshje garuese.

#### **Neni 7**

#### **E drejta për shfrytëzimin e Palestres sportive**

- a. Të drejtë shfrytëzimi të palestres sportive kanë: Institucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike dhe afariste, shkollat fillore dhe të mesme, Universitetet dhe Institucionet ndërkombëtare, organizatat jo qeveritare, bizneset dhe grupet formale.
- b. Mënyra e shfrytëzimit rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me zyren administrative të palestres.

#### **Neni 8**

#### **Rregullat themelore për shfrytëzimin e objekteve sportive (rendi shtëpiak)**

- a. Kërkohej nga të gjithë shfrytëzuesit e palestres që ta respektojnë këtë rregullore me përpikmëri.
- b. Kujdestari i palestrës është autoriteti më i lart dhe atij duhet ti bindet secili shfrytëzues i palestrës gjatë gjithë kohës. Për pakënaqësitë e supozuara, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DKRS.
- c. Kujdestari ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e rregullores deri në një vendim të komunës së Pejës.
- d. Shfrytëzuesi i palestres duhet të identifikohet dhe të regjistrohet cdo herë para shfrytëzimit të palestres.
- e. Ndalohet pirja e duhanit në brendësi të palestres, në të gjitha pjesët e saj.
- f. Pas shfrytëzimit të hapsirave në palestër dhe zhveshtore, dorëzimi i gjendjes bëhet te kujdestarët pas verifikimit të hapsirave të shfrytëzuara nga shfrytëzuesi i objekteve sportive.
- g. Klubet dhe individët duhet të kujdesen vetë për gjërat e tyre personale. Palestra nuk e merrë përgjegjësinë për gjërat e humbura në palestër.
- h. Shfrytëzimi i palestres bëhet vetëm me pagesë sipas tarifës së caktuar nga komuna apo sipas marrëveshjes së arritur me DKRS.
- i. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestres. Përfshihen rastet kur ka ndonjë marrëveshje të posaqme me DKRS-në.



- j. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të pa pastra dhe këpucë që lëjnë gjurmë.
- k. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektet sportive është e ndaluar pa lejen e DKRS-së.
- l. Klubet duhet të sjellin orarin e aktiviteteve të tyre në administratën e objekteve sportive.
- m. Përdorimi i pajisjeve amplifikuese në objektet sportive duhet të aprovohet nga administrata e objekteve sportive.
- n. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë të përcjellur nga prindërit apo kujdestari i tyre.
- o. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, përjashtohet rasti kur kafsha është ndihmë e personit me aftësi të kufizuara.
- p. Në zhveshtoret nuk lejohet asnjë lloj konsumi përveq pijeve freskuese të lojes.
- q. Ndalohet hyrja me armë, përjashtohen personat e autorizuar të organeve të sigurisë.
- r. Ndalohet hyrja në palestër me bicikleta, skateboard apo çfardo mjete tjetër transportues.
- s. Ndalohet ngjitja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa lejen e kujdestarit të palestres.
- t. Jeni të vëzhguar nga kamerat vëzhguese dhe filmimet merren si prova ndaj të gjithëve.

## **Neni 9**

### **E drejta e Sponzorimeve**

- a. Reklamimi i Sponzorëve bëhet konform rregullores komunale për Taksa dhe Tarifa dhe me marrëveshje të posaqme me komunën respektivisht DKRS-në.
- b. Reklamimi i sponzorëve bëhet në këto vende: dysheme; në anësore të fushës; në rrethoja; në mure të objekteve; në hapsira të jashtme.
- c. Në dysheme mund ti vendosin reklamat e veta vetëm sponzorët që kontribuojnë me vlerën minimale prej 10,000.00 € në vit.
- d. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së reklamave dhe obligohen që t'i marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimet e nevojshme.
- e. Të drejtë për vendosjen e reklamave në objektet sportive kanë të gjitha firmat/organizatat që arrinë marrëveshje me klubet sportive që i shfrytëzojnë objektet sportive dhe me komunën.

## **Neni 10**

### **Kushtet e Reklamimit në Objektet Sportive**

- a) Të gjitha klubet duhet ta pranojnë marrëveshjen e komunës për reklamimin e firmes partnere (nëse ekziston një e till) në objektet sportive sipas marrëveshjes së posaqme.
- b) Reklamat e vendosura në dysheme mund të hiqen apo të mbulohen nga secili klub në ndeshjet e tyre si vendas, por klubi është i detyruar që ta kthejë atë në gjendje të mëparshme para se klubi i dëmtuar të luaj ndeshjet si vendas.

- c) Nëse nga klubi nuk respektohet pika b) e këtij neni, atëherë, DKRS do ta kryej këtë punë dhe klubi përgjegjës do t'a paguaj fakturen e shërbimit.
- d) Për mos respektimin e pikës b) të këtij neni, ndaj klubit përgjegjës do të merren masa penale sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 11**

#### **Kushtet, Përgjegjësitë dhe Përfitimet për shfrytëzuesit e objekteve sportive**

1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet të deponojnë në Drejtoratin për Kulturë Rini dhe Sport, dokumentet siq vijon:
  - a) Certifikaten e regjistrimit
  - b) Certifikaten fiskale
  - c) Lejen e njoftimit të personit përgjegjës
  - d) Listen e anëtarëve të kryesise
  - e) Listen e anëtarëve (lojtarëve) të klubit
  - f) Pasqyren financiare (të hyrat dhe shpenzimet e klubit)
2. Klubet janë të obliguara të nënshkruajnë marrëveshje me DKRS-në me të cilën definohen përgjegjësitë.
3. Palët tjera që nuk janë klube sportive, për shfrytëzimin e palestres sportive duhet të paraqesin planin e aktiviteteve që duan të zhvillojnë në palester dhe të nënshkruajnë marrëveshje për shfrytëzimin e palestres.

### **Neni 12**

#### **Pagesat për shfrytëzimin e objekteve sportive**

- a) Për shfrytëzimin e objekteve sportive palët janë të obliguara të paguajnë sipas rregullores për taksa dhe tarifa apo sipas marrëveshjes së posaqme të arritur me DKRS-në.
- b) Pagesat duhet të realizohen para shfrytëzimit të objekteve sportive.
- c) Pagesat kryhen tek zyrtari administrativ i objekteve sportive apo në DKRS në zyrën e financave.

### **Neni 13**

#### **Kujdesi dhe mirëmbajtja e Palestres**

- a) Për objektet sportive kujdeset stafi përgjegjës i palestres sportive duke bashkvepruar me operatorët e kontraktuar nga komuna e Pejës.
- b) Mirëmbajtjen e hapsirave të palestres mund ta bëjnë edhe firma tjera të cilët e bëjnë atë në formë vullnetare dhe pa pagesë.

**Neni 14**  
**Rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit**

- a) Ndryshimet në objektin e palestres bëhen vetëm me lejen e komunës respektivisht kryetarit të komunës së Pejës.
- b) Projektet për investime kapitale në palestër bëhen duke u bazuar në udhëzimet e akteve ligjore dhe nën ligjore që e rregullojnë veprimin përkatës.

**Neni 15**  
**Masa Ndëshkuese**

- a) Ndaj palëve që nuk e respektojnë këtë rregullore dhe rregulloren e brendshme merren masa ndëshkuese.
- b) Masa ndëshkuese për mosrespektimin e rregulloreve të objekteve sportive e vendosë Bordi i Drejtorëve duke u bazuar në dëshmi dhe raportet e zyrës administrative.

**Neni 16**  
**Dispozitat Kalimtare**

- a) Menaxhmenti i palestres është i obliguar ti njoftoj të gjitha palët për ekzistimin e kësaj rregulloreje nëpërmjet mekanizmave ligjor: një kopje për secilen palë që i shfrytëzon objektet sportive; ngjitja e rendit shtëpiak (neni 8) në secilen hapsirë të objekteve sportive, publikimi i rregullores në faqen elektronike të komunës, nëpërmjet emailit.
- b) Ndryshimet e rregullores bëhen me miratimin e Kuvendit Komunal të Pejës.

**Neni 17.**

- a) Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

**01.Numer: 400 - 85581**

**Pejë, datë: 30 Janar 2015**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**



**KRYESUESI,**  
**Dr. Islam Husaj**